

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**

Nr i prokurimit **213-21-190-5-1-1**

Nr i brendshëm **213 21 002 51**

Sa i përket tenderit për **Faza II - Ujësjetësi Shipol - Brus, Mitrovicë.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ALFA.I SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ibrahim Rugova pn.

(Adresa)

Lipjan

14 000

(Vendi)

(Kodi postar)

00383 38 606 706

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Lulzim JAHAJ


(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@alfa-i.com

(Adresa elektronike)

12.04.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nenshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 25.01.2021
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 08.03.2021
Njoftimi mbi vendimin e AK: 22.03.2021
Kërkesa për rishqyrtim dt.29.03.2021
Vendim nga AK-ja në kërkesë për rishqyrtim nuk kemi marrë

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 108/A i LPP-së
Neni 39.8 i RRUOPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, ne me dt. 22.03.2021 ne platformën elektronike të prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku jemi shpallur si tenderues të eliminuar, ndërsa është rekomanduar për kontratë Grupi i OE "ILEAA-GR" SH.P.K.; "Infra-Plus" SH.P.K.; "Ejup Shabani B.I".

Ju sqarojmë se arsyet për eliminimin tonë nuk qëndrojnë për faktet si në vijim:

Sa i përket arsyes për eliminimin tonë është cekur se “OE ka prezantuar inxhinierin e ndërtimtarisë-konstruktiv vërtetimin e noterit, mirëpo diploma nuk ka vulën e noterit, siç kërkohet në DT” dhe “OE ka prezantuar inxhinierin e elektroteknikës me diplomë të noterizuar nga OE e jo siç është kërkuar në DT nga vetë inxhinieri”, ju sqarojmë se kjo arsye e eliminimit nuk qëndron për faktin se diplomat janë të noterizuara ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit për secilin nga inxhinierët, e edhe për inxhinierët për të cilët jemi eliminuar. Nëse analizohen në tërësi të gjitha dokumentet të cilët ne i kemi prezantuar në ofertën tonë shihet qartë se diplomat e inxhinierëve janë të noterizuara ashtu siç janë kërkuar në dosje të tenderit, andaj është absurde arsyeja për eliminimin tonë për faktin se ne e plotësojmë kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në lidhje me noterizimet. Ndërsa sa i përket arsyes tjetër ku është cekur se për inxhinierin e ndërtimtarisë i mungojnë referencat, fillimisht ju sqarojmë se në lidhje me këtë inxhinier ne e kemi prezantuar si staf shtesë (si dëshmi më tepër) dhe e plotësojmë kërkesën, mirëpo sa i përket kësaj arsye ju sqarojmë se AK nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, pasi që nuk janë kërkuar sqarime shtesë në lidhje me referencat për inxhinierin, prandaj ky veprim i AK-së kundrejt nesh shihet qartë si tendencë dhe diskriminim.

Sa i përket arsyes për eliminimin tonë në lidhje me pajisjet ku është cekur se është kërkuar makineri saldimi ballor 2 copa për gypa HDPE dhe është kërkuar makineri saldimi elektrofuziv 3 copa për gypa HDPE, kurse ju nuk i keni prezantuar konform kërkesës së dosjes së tenderit, ju sqarojmë se kjo arsye e eliminimit është plotësisht e pabazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne i kemi prezantuar makineritë për saldim ballor dhe saldim elektrofuziv, ashtu siç është specifikuar në dosje të tenderit. AK-ja siç duket nuk e ka analizuar në tërësi dokumentacionin e prezantuar nga ana jonë në ofertë, mirëpo nëse analizohen në tërësi të gjitha dokumentet e prezantuara nga ana jonë atëherë shihet qartë se ne e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Nëse eventualisht AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me makineritë e lartcekura kanë mundur të kërkojnë sqarime shtesë dhe ne do të ju kishim ofruar ato dhe ta vërtetonim se e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit, mirëpo që një veprim të tillë, AK-ja nuk e ka bërë.

Po ashtu edhe arsyeja tjetër për eliminimin tonë ku është cekur se kinse nuk kemi ofruar dëshmi për makinën shpuese horizontale nëntokësore me sistemin laser të kontrollimit prej DN 250-DN 1400 siç kërkohet në DT, është e paqëndrueshme, sepse ne e kemi prezantuar pajisjen e lartcekur konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe i kemi ofruar të gjitha dëshmitë ashtu siç është specifikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë. Andaj përderisa ne i kemi ofruar makineritë ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, arsyet e AK-së për eliminimin tonë janë absurde dhe nuk qëndrojnë.

Gjithashtu edhe arsyeja tjetër për eliminimin tonë në lidhje me certifikatat ISO është e pabazuar, sepse ne i kemi ofruar të gjitha ato sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ku të gjitha janë të noterizuara dhe të prezantuar ashtu siç janë kërkuar. Mirëpo nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me ISO certifikatat e prezantuara nga ne ka mundur të kërkojë sqarime shtesë në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, mirëpo që një veprim të tillë nuk e ka bërë, duke na diskriminuar haptas neve si OE i përgjegjshëm. Gjithashtu nëse eventualisht do të mungonte ndonjëra nga ISO certifikatat e kërkuara edhe pse ne e kemi ofruar të gjitha ISO e kërkuara, atëherë AK-ja është dashur ti respektojë dispozitat e neni 39.8 të RRUOPP-së, ku parashihet qartë se Mungojnë certifikatat ISO-Mund të kërkojnë sqarime shtesë, andaj përderisa AK-ja nuk ka kërkuar sqarime shtesë atëherë nuk është respektuar dispozita e nenit të lartcekur të RRUOPP-së. (Ju lutem analizoni edhe një herë në tërësi dokumentet e prezantuara nga ne). AK-ja nuk e ka marr parasysh fare faktin e diferencës së çmimit me

të cilin kemi ofertuar ne dhe OE i rekomanduar për kontratë, ku është diferencë e madhe, e ku ne jemi më të lirë prej **715,991.13 €**.

Ne pajtohemi me arsyet e eliminimit të OE "LEDI ING" SH.P.K, pasi që siç dhe pajtohem se ky OE është i papërgjegjshëm.

Ne nuk kemi marr përgjigje/vendim në kërkesën për rishqyrtim brenda afateve të përcaktuara me LPP, prandaj AK-ja nuk ka respektuar nenin 108/A të LPP-së, për të cilën shkelje kërkojmë që të merren masa ndaj zyrtarëve përgjegjës të autoritetit kontraktues.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatohet se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, edhe pse janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. AK-ja me këtë veprim duke e rekomanduar për kontratë këtë OE po rrezikon ta dëmtojë buxhetin e shtetit në vlerë prej 715,991.13 €.

Autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të marr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **ALFA.I SH.P.K.**

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përkrahja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

